



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.9, datë 28.01.2021

PËR
MIRATIMIN E VENDNDODHJES SË TERMINALIT JUGOR TË AUTOBUSËVE NË
BASHKINË E DURRËSIT

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenit 21.1 të Ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998, “Për Transportet Rrugore” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 446, datë 10.5.2018 “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë Terminali i Autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të Terminalit të Autobusëve”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,


KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e vendndodhjes së Terminalit Jugor të transportit të autobusëve, në Bashkinë Durrës sipas genplanit bashkëlidhur si Aneksi nr.1.
2. Drejtoria e Shërbimeve të ndjek të gjitha procedurat ligjore në zbatim të akteve ligjore në fuqi për vijimin e procedurave të mëtejshme.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.01.2021







2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 89 / prot.
9



Durrës, më 02 .02 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 09 datë 28.01.2021
“Për miratimin e vendndodhjes së terminalit jugor të autobusëve në Bashkinë e Durrësit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016
“Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

